



**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 28/2021 (JR)
Nr. 28/.6 regj.**

Tiranë më 15.05.2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 15.05.2024, në seancën e thirrur në orën 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 28/2021, datë 25.05.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Rita Gjati kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 358, datë 19.03.2021, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, ditën e hënë, në datën **27.05.2024, ora 10:00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, për shkak të konstatimit të shkeljeve të rënda procedurale dhe për t’i siguruar subjektit të rivlerësimit të drejtën për tu dëgjuar e mbrojtur.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjyqësor
Relator i Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare**

**Ina Rama
Sokol Çomo
Natasha Mulaj
Rezarta Schuetz
Mimoza Tasi**

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**


INA RAMA 
